



RAPORTI VJETOR
ANNUAL REPORT **2013**

ATRC - Prishtina 2013

RAPORTI VJETOR 2013

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

Letër nga Drejtori Ekzekutiv.....	3
Për ATRC.....	4
Misioni.....	5
Partnerët.....	6
Përkrahësit.....	7
Programi për trajnime dhe ngritje kapacitetesh.....	8
Konsulentat individuale.....	9
Programi për menaxhim të granteve.....	10
Raundi i dytë i granteve	14
Praktikat dhe procedurat per monitorimin e gjykatave.....	15
Përcjellja e aktiviteteve të monitorimit të gjykatave.....	16
Prezantimi i të gjeturave nga monitorimi i gjykatave në çështjet e grave.....	17
Prezantimi i te gjeturave finale nga monitorimi i gjykatave	18
Programi për avokim / Drejtësia dhe qytetarët	19
Qytetarë aktiv - Komuna të përgjegjshme dhe transparente	21
Fuqizimi i qytetarëve dhe komunave drejt zhvillimit demokratik / Monitorimi i procesit të të zhvendosurve nga vendet e treta	22
Politika energjetike të qëndrueshme në evropë jug-lindore (SEE SEP).....	23
Zhvillimi i ENV.Net në ballkanin perëndimor dhe Turqi : Dhënë qytetarëve zërin.....	25
Promovimi i diversitetit kulturor në Kosovë.....	25
Programi për informim	26
Botimet e ATRC gjatë vitit 2013.....	27
ATRC në media.....	28
Raporti financiar	29
Bordi i ATRC-së.....	30
Stafi i ATRC-së.....	30

LETËR NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Të nderuar partnerë,

Duke synuar që t'ju informojmë ju dhe publikun e gjerë për angazhimet e ATRC kemi përgaditur një përmbledhje të aktiviteteve dhe projekteteve të implementuara si dhe rezultateve të arritura gjatë vitit 2013.

ATRC edhe këtë vit është angazhuar në implementimin e një sërë aktiviteteve dhe projektesh, që kanë për qëllim forcimin e rolit të OJQ-ve, shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve si dhe avokimin në institucione lokale dhe nacionale për çështje të interesit të përgjithshëm, bazuar në katër programet kryesore të saj: Programi i administrimit të granteve, Programi i ngritjes së kapaciteteve, Programi i avokimit dhe Programi i informimit.

Ky vit për ATRC vlerësohet vit i sukseseve, zgjerimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit si dhe zgjerimit të kapaciteteve të brendshme të saj. ATRC ka vazhduar bashkëpunimin me organizata e institucione të ndryshme qeveritare në nivele lokale dhe nacionale, organizata joqeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në inicimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Angazhimi i ATRC në zhvillimin dhe përkrahjen e organizatave joqeveritare ka vazhduar edhe këtë vit, përmes ngritjes së kapaciteteve dhe njëkohësisht përkrahjen e tyre në implementimin e projekteve, në fushën e monitorimit të gjykatave dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë, në kuadër të projektit "Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrjes në sistemin e drejtësisë", që financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Njëkohësisht, ATRC ka realizuar një sërë trajnime, punëtori dhe konsulencë individuale nga të cilat kanë përfituar OJQ, qytetarë dhe institucione të ndryshme.

ATRC ka vazhduar me organizimin e fushatave avokuese në nivel lokal dhe nacional, duke synuar fuqizimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje, pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, kontribuimin në përmirësimin e marrëdhënieve në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve si dhe lehtësimin e mekanizmave për angazhim qytetar.

Në emër të ATRC, falënderoj donatorët, që me përkrahjen e tyre na mundësuan që edhe këtë vit të kontribuojmë në zhvillimin demokratik të vendit tonë si dhe në zhvillimet regjionale. Falënderoj Agjencionin e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar- USAID, Departamentin Amerikan të Shtetit përmes Grupit të së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG), Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Agjencionin Suedez për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme, UNHCR, Komisioni Europian, The Balkan Trust for Democracy-BTD, The United Nations Development Programme-UNDP dhe Këshillin e Evropës.

ATRC, në përputhje me misionin e saj, do të vazhdoj me përkushtim angazhimin e saj në zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Me respekt,
Kushtrim Kaloshi
Drejtor Ekzekutiv



PËR ATRC

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar OJQ-të Kosovare në profesionalizimin e punës së tyre, artikullimin e kërkesave të tyre dhe ka avokuar tek strukturat qeveritare për çështje me rëndësi për shoqërinë Kosovare. ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes ofrimit të trajnimeve dhe konsulencave, të ngris kapacitetet e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe institucioneve publike në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve, avokimit dhe qeverisjes me pjesëmarrje.

2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale përmes granteve, duke synuar ndryshime të politikave publike, inicim të ligjeve dhe rregulloreve, praktika të reja në të mirë të publikut, fushata edukimi dhe sensibilizimi për çështje të ndryshme si: transparenca dhe llogaridhënia, mjedisi, të drejtat e pakicave, etj.

3. Programi për Avokim-ATRC e vetme dhe në partneritet me organizata tjera, në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e identifikuara në komunitet t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar.

4. Programi për Informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

ATRC beson se ndërtimi i koalicioneve dhe partneriteteve ndërsektoriale janë shtylla kyçe për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e misionit të saj. Për këtë arsye, ATRC është në bashkëpunim të vazhdueshëm me OJQ të shumta në Kosovë, është pjesë e fushatave avokuese që kanë për qëllim zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe është pjesë e rrjeteve në nivel lokal, regional e ndërkombëtar.

MISIONI


Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse Kosovare, e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngrit kapacitetin e OJQ-

ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin fushata avokimi dhe kontribuon në krijimin e instuticioneve qeverisëse bazuar në standardet ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me instuticionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.

*"Bringing out the
advocate in everyone"*



PARTNERËT

Gjatë vitit 2013 ATRC ka vazhduar bashkëpunimin me organizata e institucione të ndryshme qeveritare në nivele lokale dhe nacionale, me organizata joqeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në inicimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Institucionet dhe agjencitë qeveritare me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2013:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)
Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)
Zyra e Prokurorit Disiplinor (KPD)
Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)
Policia e Kosovës (PK)
Zyra e Avokatit të Popullit
Gjykatat e Qarkut dhe Gjykatat Komunale të 20 Komunave të Kosovës
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Departamenti i Energjisë
Gjashtë Komuna të Kosovës: Gjiilan, Kamenicë, Novobërdë, Viti, Hani i Elezit dhe Shtërpce


Organizatrat joqeveritare rajonale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2013:

SEE Change Net - Bosnjë dhe Hercegovinë
EDEN, Ekolëvizja dhe CO-PLAN - Shqipëri
CZZS dhe Public Interest Advocacy Center - Bosnjë dhe Hercegovinë
Society for Sustainable Development Design dhe Forum for Freedom Education – Kroaci
Association for Policy Research Analytica – Maqedoni
Eko-Svest dhe Environmental Citizens' Association - Maqedoni
Green Home dhe MANS - Mali i Zi
Fractal, CEKOR dhe EASD – Serbi
Fondacione Punto.Sud - Itali
TEMA - Turqi

EEB - Belgjikë

Organizatrat Joqeveritare lokale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2013:

Shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini,” sh.p.k. – Prishtinë
Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - Prishtinë
Civil Rights Program in Kosovo (CRP/K) - Prishtinë
Qendra Juridike e Kosovës (KLC)- Prishtinë
Rrjeti Rinor i Kosovës (KYN)- Prishtinë
Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) - Prishtinë
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)- Prishtinë
Komunikimi për Zhvillim Social (CSD) - Gracanicë
Proactive - Kamenicë
Elita - Viti
Agro Eco - Gjiilan
IRP - Ferizaj
Iniciativa 6 - Prizren
Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamë të Dobësuar të Kosovës (ShVPDK) - Prishtinë



PËRKRAHËSIT

Përkrahësit e ATRC-së gjatë vitit 2013 kanë qenë:

Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

<http://www.usaid.gov/kosovo>

Departamenti Amerikan i Shtetit përmes Grupit të së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG)

www.justiceandthepeople.org

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë

<http://pristina.usembassy.gov>

Agjensioni i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) www.sida.se

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme www.palmecenter.org

Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) <http://www.unhcr.org>;


Komisioni Europian/ The Balkan Trust for Democracy-BTD/ The United Nations Development Programme-UNDP

http://ec.europa.eu/enlargement/index_en.htm/, <http://www.gmfus.org/balkantrust/>,

<http://www.ks.undp.org/>

Këshilli i Evropës

http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/default_en.asp



PROGRAMI PËR TRAJNIME DHE NGRITJE KAPACITETESH

Ky program ka për qëllim t'ju ofroj OJQ-ve metodat dhe mjetet e duhura për të iniciuar ndryshime në komunitetet e tyre. Dita ditës këto organizata ballafaqohen me sfida të reja dhe nevojat e tyre nuk janë të njëjta

si më parë, andaj edhe ATRC në vazhdimësi ndryshon programin e saj duke prezantuar trajnime më të avancuara dhe me tema të reja, në mënyrë që nevojat e përfituesve të saj të reflektohen në këtë program.

Gjatë vitit 2013, trajnerët e ATRC-së në kuadër të projekteve kanë realizuar 27 trajnime dhe punëtori, nga të cilat kanë përfituar OJQ, qytetarë dhe institucione të ndryshme. Gjithashtu, ATRC ka realizuar edhe 10 trajnime në përputhje me kërkesat e Save the Children në Kosovë, Shoqata e të verbërve dhe me të pamë të dobësuar - SHVPDK dhe organizatat lokale të përkrahura nga fondet e USAID.

Temat e përfshira në Programin e trajnimeve:

- Dizajnimi i Projekt Propozimit
- Menaxhimi i Ciklit të Projektit
- Menaxhimi i OJQ-ve dhe Ngritja e fondeve
- Avokimi dhe Ndërtimi i Koalicioneve
- Roli i OJQ-ve në Shoqërinë Civile
- Qeverisja e Mirë
- Lidershipi dhe Menaxhimi
- Planifikimi Strategjik
- Monitorimi dhe Vlerësimi

- Marëdhëniet Ndërmjet OJQ-ve dhe Mediave
- Komunikimi Efektiv
- Komunikimi me Klient
- Menaxhimi Bazik Financiar
- Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingu
- Menaxhimi i Konfliktëve
- Negociatat
- Qeverisja me Pjesëmarrje
- Planifikimi Kooperues
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Infrastruktura ligjore që reflekton punën e komunave në Kosovë
- Mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse
- Funksionimi i qeverisë lokale
- Planifikimi i projekteve në komunitet
- Barazia gjinore



KONSULENCAT INDIVIDUALE

Ndryshe nga trajnimet formale të cilat u dedikohen një audience më të madhe, konsulencat janë të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të individëve dhe organizatave në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, ATRC praktikon metodën e kombinimit të dy shërëbimeve: trajnimet me konsulenca individuale, duke synuar të përmbush sa më mirë nevojat e çdo përfituesi dhe njëkohësisht të ngris efektivitetin e pro-

gramit të saj.

Gjatë vitit 2013, janë zhvilluar 37 konsulenca individuale në çështje që kanë të bëjnë me shkrim të projekt propozimeve, zhvillim organizativ, menaxhim financiar, etj.

PROGRAMI PËR MENAXHIM TË GRANTEVE SJELLJA E DREJTËSISË MË AFËR QYTETARËVE NGRITJA E VETËDIJES SË QYTETARËVE DHE PJESËMARRJES NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Duke filluar nga shkurti 2013, Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është duke zbatuar projektin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për qasjen në drejtësi me titull “Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrjes në sistemin e drejtësisë”, në kuadër të programit USAID Forward.

Përmes kërkesës për parashtrimin e aplikacioneve (KPA), ATRC ka shpallur konkursin për grante për organizatat e shoqërisë civile (OSHC), grupet e komunitetit dhe individët. Qëllimet e projektit sipas KPA kanë qenë zgjerimi i komunitetit të organizatave dhe individëve të përfshirë në nismat e monitorimit të gjykatave në Kosovë, si dhe natyra, shfrytëzimi dhe mjetet e përdorura për monitorimin e nismave nëpër gjykata me objektivin e përgjithshëm të përfshirjes së sa më shumë njerëzve në sistemin gjyqësor dhe krijimin e mundësive qytetarëve që të promovojnë reformat në sektorin e drejtësisë dhe për të përmirësuar performancën e gjykatës. Këto qëllime do të përmbushen duke ndarë grante organizatave të cilat implementojnë projekte të monitorimit të gjykatës, përfshirë por pa u kufizuar në monitorim të gjykatës që synon përmirësimin e marrëdhënieve në mes të gjykatës dhe komunitetit.

Me 14 maj 2013, 13 organizata lokale janë shpërblyer për të implementuar projekte në mbarë Kosovën. Totali i buxhetit në dispozicion për këtë KPA ka qenë 115,000 dollarë USD. 13 Organizata, përfituese të granteve për këtë projekt të USAID/ATRC, kanë synuar që të:

- Shtojnë vetëdijen e qytetarëve dhe pjesëmarrjen në sistemin e drejtësisë;
- Shtojnë numrin e përgjithshëm të njerëzve nga komuniteti të përfshirë në nismat e monitorimit të gjykatave;
- Shfrytëzojnë informatat e mbledhura gjatë monitorimit të gjykatave me qëllim të reko mandimit të përmirësimeve apo për të avokuar për ndryshim;
- Shtojnë njohuritë brenda komunitetit lokal për gjykatat lokale.

Më poshtë ju ofrojmë një pasqyrë të shkurtër të të gjitha projekteve të cilat janë shpërblyer me grante gjatë vitit 2013:

Emri i Përfituesit të Grantit: Këshilli i Kongresit të Intelektualëve Boshnjakë të Kosovës - VKBIK
Titulli i Projektit: Qytetarët dhe Gjykatat
Lokacioni i Organizatës: Prizren
Lokacioni i Projektit: Prizren
Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,000

Përshkrim i shkurtër i projektit
VKBIK ka monitoruar Gjykatën Themelore të Prizrenit për të siguruar një prani të vazhdueshme publike nga një pikëpamje neutrale. Përmes monitorimit të drejtpërdrejtë, VKBIK ka ofruar edhe rekomandime për administratën gjyqësore në mënyrë që të përmirësoj proceset dhe procedurat e saj.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra për Avokim dhe Zhvillim të Kosovës - KADC
Titulli i Projektit: Gjykatat si një model për ndalimin e përdorimit të duhanit
Lokacioni i Organizatës: Prishtinë
Lokacioni i Projektit: Prishtinë
Kohëzgjatja e Projektit: 6 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit
Projekti ka synuar të mbështes gjykatat në Kosovë në përmirësimin e sundimit të ligjit, në kuadër të institucioneve gjyqësore dhe në mesin e popullatës së përgjithshme. Përmes këtij projekti KADC ka monitoruar respektimin e ndalimit të duhanit brenda ndërtesave të gjykatave, duke përfshirë sallat dhe objektet, nga ana e vetë personelit të gjykatës. Së dyti, KADC ka monitoruar zbatimin e gjobave të reja të lëshuara nga inspektoratet e ndryshme përgjegjëse për zbatimin e ligjit të ri për duhanin.

Emri i Përfituesit të Grantit: Seksioni i Grave nga Obiliqi - SZO
Titulli i Projektit: Qytetarët dhe Drejtësia
Lokacioni i Organizatës: Fushë Kosovë
Lokacioni i Projektit: Fushë Kosovë
Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit
Nëpërmjet këtij projekti SZO ka synuar t'i edukoj qytetarët se si ata mund të kenë qasje në institucionet gjyqësore, të rris besimin e qytetarëve që sistemi i drejtësisë mund të veproj në mënyrë efektive, t'i motivoj komunitetet pakicë në fshatrat e komunës së Fushë Kosovës të jenë përdorues të gjykatave në Kosovë për arritjen e drejtësisë, të jetë kritik i mangësive në gjyqësorin dhe ithtarët e reformave dhe për të inkurajuar përfshirjen e juristëve të rinj në institucionet e gjyqësorit në Kosovë. ligjit të ri për duhanin.

Emri i Përfituesit të Grantit: Green Art
Titulli i Projektit: Komunikimi për efektivitetin
Lokacioni i Organizatës: Prizren
Lokacioni i Projektit: Prizren
Kohëzgjatja e Projektit: 6 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,000

Përshkrim i shkurtër i projektit
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuoj në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Emri i Përfituesit të Grantit: Femrat Aktive të Gjakovës - AGJK

Titulli i Projektit: Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe rritja e pjesëmarrjes së grave

Lokacioni i Organizatës: Gjakovë

Lokacioni i Projektit: Gjakovë

Kohëzgjatja e Projektit: 6 Muaj

Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit

Përmes këtij projekti organizata Femrat Aktive të Gjakovës ka patur për qëllim të rris ndërgjegjësimin në mesin e grave të Kosovës rreth të drejtave të tyre juridike pronësore dhe se si të qasen në drejtësi në mënyrë efektive. AGJK ka monitoruar këto raste në gjykata dhe nëse kanë një vështrim nga afër të realitetit në seancat e shqyrtimit kryesor: si shkojnë procedurat dhe nëse gjyqtari informon gruan se ajo është duke e braktisur të drejtën e saj.

Emri i Përfituesit të Grantit: Lëvizja FOL

Titulli i Projektit: Afrimi i qytetarëve me institucionet e drejtësisë

Lokacioni i Organizatës: Gjakovë dhe Podujevë

Lokacioni i Projektit: Gjakovë dhe Podujevë

Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj

Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit

Përmes këtij projekti FOL ka patur për qëllim të përmirësoj komunikimin dhe angazhimin në mes të qytetarëve dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë në nivel komunal.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra Rinore e Pavarur Kulturore Informative - ELITA

Titulli i Projektit: Transparenca rrit besimin e qytetarëve në gjykata

Lokacioni i Organizatës: Viti

Lokacioni i Projektit: Viti, Gjilan

Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj

Fondet e Projektit: US \$ 8,500

Përshkrim i shkurtër i projektit

Qëllimi i këtij projekti është rritja e nivelit të besimit në punën e Gjykatës Themelore në Viti dhe angazhimin e saj për ngritjen e nivelit të sundimit të ligjit.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra Rinore e Pavarur Kulturore Informative - ELITA

Titulli i Projektit: Transparenca rrit besimin e qytetarëve në gjykata

Lokacioni i Organizatës: Viti

Lokacioni i Projektit: Viti, Gjilan

Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj

Fondet e Projektit: US \$ 8,500

Përshkrim i shkurtër i projektit

Qëllimi i këtij projekti është rritja e nivelit të besimit në punën e Gjykatës Themelore në Viti dhe angazhimin e saj për ngritjen e nivelit të sundimit të ligjit.

Emri i Përfituesit të Grantit: Organizata Publike për Iniciativa Lokale dhe Mbështetëse - POLIS

Titulli i Projektit: Drejtësia civile me qasje në një shërbim të drejtë gjyqësor

Lokacioni i Organizatës: Lipjan

Lokacioni i Projektit: Lipjan

Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj

Fondet e Projektit: US \$ 8,000

Përshkrim i shkurtër i projektit

Nëpërmjet këtij projekti POLIS ka monitoruar të gjitha rastet gjyqësore që kanë të bëjnë me trashëgiminë e pronës. POLIS gjithashtu ka monitoruar punën e gjykatës nëse ajo i jep informacione të mjaftueshme palëve të drejtave të tyre në lidhje me këtë fenomen, si dhe ka zhvilluar një fushatë avokimi dhe ndërgjegjësimi pas analizimit të të gjeturave nga monitorimi.

Emri i Përfituesit të Grantit: Proactive
Titulli i Projektit: Qytetarë aktiv më afër Drejtësisë
Lokacioni i Organizatës: Kamenicë
Lokacioni i Projektit: Kamenicë
Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 8,000

Përshkrim i shkurtër i projektit
Përmes këtij projekti Proactive ka patur për qëllim rritjen e efikasitetit të Gjykatës Komunale të Kamenicës në trajtimin e rasteve që lidhen me prerjet ilegale të pyjeve në territorin e saj.

Emri i Përfituesit të Grantit: Iniciativa Përparimtare Rinore - IPR
Titulli i Projektit: Drejtësi për të gjithë
Lokacioni i Organizatës: Ferizaj
Lokacioni i Projektit: Ferizaj
Kohëzgjatja e Projektit: 6 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 8,000

Përshkrim i shkurtër i projektit
Iniciativa Përparimtare Rinore ka monitoruar punën e gjykatës themelore dhe ka synuar ndryshime pozitive, duke gjetur format e bashkëpunimit në uljen e rasteve të rrezikut dhe shpyllëzimit.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra e Grave Prehja
Titulli i Projektit: Ngritja e vetëdijes të qytetarëve të komunës së Skenderajt për reformat gjyqësore
Lokacioni i Organizatës: Skenderaj
Lokacioni i Projektit: Skenderaj
Kohëzgjatja e Projektit: 7 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,000

Përshkrim i shkurtër i projektit
Qendra e Gruas Prehja ka monitoruar punën e Degës së Gjykatës Themelore në Skenderaj në lidhje me kritikën e rasteve që lidhen me dhunën në familje, si një fenomen i dukshëm dhe shqetësues, i cili edhe përkundër faktit se ka infrastrukturë të mjaftueshme ligjore nuk ka rënë.

Emri i Përfituesit të Grantit: Shoqata e Kontabilistëve të Grave - Venera
Titulli i Projektit: Parandalimi i shmangies së të drejtave trashëgimore të grave
Lokacioni i Organizatës: Pejë
Lokacioni i Projektit: Pejë
Kohëzgjatja e Projektit: 6 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 8,000

Përshkrim i shkurtër i projektit
Projekti ka patur për qëllim që të siguroj që gratë trajtohen si trashëgimtare të barabarta në aspektin e pronës së përbashkët brenda familjeve në rajonin e Pejës. Venera ka zhvilluar një raport monitorimi të gjykatës dhe bazuar në gjetjet ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësimi publik.

Emri i Përfituesit të Grantit: Shoqata e Medias së Kosovës - KOSMA
Titulli i Projektit: Qasja e Drejtësisë në Radio Buletin
Lokacioni i Organizatës: Çagllavicë, Graçanicë
Lokacioni i Projektit: Graçanicë
Kohëzgjatja e Projektit: 6 Muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit
Nëpërmjet këtij projekti Kosma ka synuar që të siguroj informacione të balancuara dhe të paanshme për audiencën serbe të Kosovës, duke mundësuar të drejtën e lirisë së shprehjes, të drejtën për komunikim, dhe të drejtën për qasje në drejtësi përmes një seri programesh të radios.

RAUNDI I DYTË I GRANTEVE - “NGRITJA E VETËDIJES SË QYTETARËVE DHE PJESËMARRJES NË SISTEMIN E DREJTËSISË”

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) në kuadër të projektit të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për qasjen në drejtësi me titull “Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrjes në sistemin e drejtësisë”, në muajin nëntor 2013, ka shpallur raundin e dytë të granteve përmes kërkesës për parashtrimin e aplikacioneve (KPA). Objektivat e grantit (eve) sipas Ftesës për Aplikim kanë qenë të shtohet qasja e qytetarëve të Kosovës në sistemin gjyqësor, duke i vënë organizatat vendore përballë sistemit gjyqësor në përgjithësi si dhe përballë sfidave dhe mundësive për funksionim më të mirë të gjykatave dhe për vënie të drejtësisë në gjykata në nivelin lokal; që të shtohet vetëdija publike dhe besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në debate në mënyrë efektive dhe t’i mbështetin në mënyrë proaktive përpjekjet e institucioneve të sektorit të sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë civile për ta shtuar transparencën, për ta luftuar korrupsionin dhe për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi përmes administrimit të drejtë, transparent dhe efektiv të drejtësisë në Kosovë.

Zbatimi i nismave të projektit për raundin e dytë të granteve do të filloj nga janari i vitit 2014.

Dy thirrjet për aplikim janë publikuar në media të ndryshme të shkruara dhe elektronike. Njëkohësisht, ATRC për secilin raund të granteve ka organizuar takime informative në nëntë komuna të Kosovës, me OJQtë e interesuara për t’ju ofruar informata më të detajuara rreth procesit të aplikimit për grante.

Procesi i vlerësimit të dhënies së granteve është proces i hapur dhe transparent, i cili realizohet nga Bordi për Grante dhe Shpërblime (BGSh), që përbëhet nga tre anëtarë të jashtëm dhe të cilët janë të ndryshëm në secilin raund të granteve.

Me qëllim të arritjes së ndikimit maksimal, ATRC i ka ofruar secilit përfitues të grantit shërbime për zhvillimin e kapaciteteve, përmes burimeve të brendshme dhe të jashtme, ashtu që të gjithë përfituesit e grantit të zbatojnë me sukses projektet e tyre. Gjatë këtij viti, ATRC ka organizuar dy punëtori dhe dy tryeza të rrumbullakëta në mes 13 organizatave grantmarrëse dhe përfaqësuesve të institucioneve gjyqësore të Kosovës.

"PRAKTIKAT DHE PROCEDURAT PËR MONITORIMIN E GJYKATAVE"

Punëtorja e parë "Praktikat dhe procedurat për monitorimin e gjykatave", organizuar nga ATRC më 24 maj 2013, kishte për qëllim sjelljen e përfaqësuesve të institucioneve gjyqësore të Kosovës në përforcimin e kapaciteteve të organizatave grantmarrëse, për infrastrukturën ligjore të gjykatave në Kosovë, ligjin e ri për gjykatat, qasjen në sistemin gjyqësor, mekanizmat ligjor në dispozicion për monitorimin e gjykatave, praktikat më të mira të komunikimit me gjykatat, etj. Veç përfaqësuesve të organizatave grantmarrëse, të pranishëm në këtë punëtori nga institucionet e drejtësisë së Kosovës ishin: Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i

Kosovës), Sadri Krasniqi (Këshilli Prokurorial i Kosovës), dhe Zef Prendrecaj (Zyra Disiplinore e Prokurorit).

Punëtorja u vlerësua mjaft pozitivisht si nga organizatat joqeveritare përfituese të granteve, ashtu edhe nga Institucionet e drejtësisë së Kosovës. Pjesëmarrësit shprehën mendimin se këto punëtori ishin një nga mundësitë e rralla për dy sektorët për të përmbushur dhe ndarë idetë e tyre në përmirësimin e sistemin të drejtësisë në Kosovë.



“PËRCJELLJA E AKTIVITETEVE TË MONITORIMIT TË GJYKATAVE”

Në muajin shtator, ATRC organizoi punëtorinë e dytë me temë "Përcjellja e aktiviteteve të monitorimit të gjykatave", për 13 organizatat grantmarrëse. Mysafirë të ftuar për të marrë pjesë ishin përfaqësues të institucioneve gjyqësore të Kosovës: Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i Kosovës), Sadri Krasniqi (Këshilli Prokurorial i Kosovës), Zef Prendrecaj (zyra e Prokurorit disiplinor).

Gjatë kësaj punëtorie organizatat grantmarrëse kanë pasur mundësi që drejtpërdrejt t'i adresojnë çështjet e tyre dhe gjetjet e mbledhura, tek përfaqësuesit e institucioneve gjyqësore të Kosovës. Të gjitha organizatat kanë marrë rekomandime dhe këshilla praktike nga përfaqësuesit e institucioneve si dhe u diskutua për pro-

gresin e përgjithshëm të projektit.

Edhe kjo punëtori u vlerësua pozitivisht nga Institucionet Gjyqësore të Kosovës dhe përfaqësuesit e organizatave grantmarrëse. Sipas përfaqësuesve të institucioneve problemet e identifikuara nga organizatat në fushën e sistemit gjyqësor janë probleme të rëndësishme që përballen qytetarët e Kosovës dhe puna e bërë deri më tani nëpërmjet këtyre projekteve do të ndihmoj në përmirësimin e punës së gjykatave në Kosovë si dhe në informimin e qytetarëve lidhur me institucionet gjyqësore. Ndërsa, përfaqësuesit e organizatave grantmarrëse thanë se punëtorja ishte një mundësi për marrjen e informatave të dobishme për zbatimin e projekteve.



TRYEZË E RRUMBULLAKËT "PREZANTIMI I TË GJETURAVE NGA MONITORIMI I GJYKATAVE NË ÇËSHTJET E GRAVE"

Më 10 Dhjetor 2013, ATRC organizoi tryezë të rrumbullakët "Paraqitja e të gjeturat nga monitorimi i gjykatave në çështjet e grave", në kuadër të projektit "Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë", të mbështetur nga USAID dhe implementuar nga ATRC. Qëllimi i organizimit të tryezës së rrumbullakët ishte mbledhja e gjashtë organizatave lokale të mbështetura nga USAID/ATRC duke u përqendruar në monitorimin e gjykatave të Kosovës që merren me çështjet e grave dhe të paraqes këto të gjetura para institucioneve të drejtësisë të Kosovës dhe publikut.

Fjalimet hyrëse në këtë tryezë u thanë nga Maureen A. Shauket (Drejtor i Misionit të USAID-it), Kushtrim Kaloshi (Drejtori Ekzekutiv ATRC) dhe Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i Kosovës). Tryeza vazhdoi me prezantimet e panelistëve, të cilin e përbënin përfaqësues të institucioneve të drejtësisë: Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i Kosovës), Sadri Krasniqi (Këshilli Prokurorial i Kosovës), Zef Prendrecaj (zyra e prokurorit disiplinor). Panelistët prezantuan reformat dhe sfidat që ndesheshin institucionet e drejtësisë gjatë këtij viti.

Tryeza vazhdoi me prezantimet e të gjeturave dhe rekomandimeve organizatat grantmarrëse për implementimin e aktiviteteve monitoruese të gjykatave për çështjet e grave. Tryeza përfundoi me reagimet e panelistëve për çdo organizatë lokale lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e tyre. Reagimet e përgjithshme të përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë ishin: monitorimi i gjykatave nga shoqëria civile është shumë i rëndësishëm në kontributin e forcimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë, në forcimin e bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë dhe të qytetarëve, si dhe të institucioneve të drejtësisë dhe të komunave; aktivitetet monitoruese të gjykatave do të nxisin besimin e qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë.

Së fundi, përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë thane se do të marrin në konsideratë rekomandimet e paraqitura nga organizatat lokale. Në këtë ngjarje ishin të pranishëm më shumë se 40 pjesëmarrës: përfaqësues të USAID-it, organizatat lokale, përfaqësues të gjykatave dhe të institucioneve të drejtësisë dhe mediat.



TRYEZË E RRUMBULLAKËT "PREZANTIMI I TË GJETURAVE FINALE NGA MONITORIMI I GJYKATAVE"

Më 20 Dhjetor 2013, ATRC organizoi tryezën "Prezantimi i të gjeturave finale nga monitorimi gjykatave", në kuadër të projektit "Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë", të mbështetur nga USAID dhe implementuar nga ATRC. Pjesëmarrës të tryezës ishin 30 përfaqësues nga organizatat grantmarrëse dhe përfaqësues të institucioneve të drejtësisë.

Qëllimi i organizimit të tryezës ishte që shtatë organizatat lokale, të mbështetura nga USAID/ATRC, që ishin përqendruar në monitorimin e gjykatave në rastet e korrupsionit, dëmtimit ilegal të pyjeve, komunikimin me qytetarë dhe implementimin e ligjit kundër duhanit të paraqesin të gjeturat e tyre para institucion-

eve të drejtësisë të Kosovës dhe publikut. Pas prezantimit të të gjeturave nga organizatat grantmarrëse, përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë: Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i Kosovës), Sadri Krasniqi (Këshilli Prokurorial i Kosovës), Zef Prendrecaj (Zyra e Prokurorit Disiplinor) dhanë rekomandime dhe këshilla praktike. Rekomandimet e përgjithshme të përfaqësuesve të institucioneve ishin: monitorimi i gjykatave nga shoqëria civile është shumë e rëndësishme në forcimin e sistemit gjyqësor në Kosovë dhe rritjen e bashkëpunimit në mes institucioneve të drejtësisë dhe qytetarëve.



PROGRAMI PËR AVOKIM

Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC në partneritet me organizata tjera dhe e vetme, në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitete t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar. Programi për avokim gjithashtu siguron një platformë për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizim me OJQ-të tjera nga Kosova dhe rajoni.

Gjatë vitit 2013, ATRC ka qenë e përfshirë në këto projekte:

- Drejtësia dhe qytetarët
- Qytetarë aktiv-Komuna të përgjegjshme dhe transparente
- Fuqizimi i qytetarëve dhe komunave drejt zhvillimit demokratik
- Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosur nga vendet e treta
- Politika energjetike të qëndrueshme në Evropën Juglindore (SEE SEP)
- Development of the ENV.Net in West Balkan and Turkey: Giving Citizens Voice
- Promovimi i diversitetit kulturor në Kosovë

DREJTËSIA DHE QYTETARËT

Kampanja “Drejtësia dhe qytetarët”, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit - Zyra ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, është një lëvizje që sjell së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile me qëllim të identifikimit të çështjeve konkrete në sistemin e drejtësisë dhe promovimin e ndryshimeve përmes avokimit publik. Qëllimi i kampanjës është që të promovojmë një qeveri më të përgjegjshme dhe të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të drejtësisë ndaj nevojave të qytetarëve.

Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët, e koordinuar nga ATRC, në muajin shkurt, organizoi një konferencë për media lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin strategjik gjyqësor të kampanjës në emër të prindërve të Diana Kastratit. Avokati Korab Sejdiu, partner në kampanjën Drejtësia dhe Qytetarët si dhe babai i të ndjerës Diana Kastrati, Gëzim Kastrati, iu drejtuan mediave lidhur me vendimin e shpallur: Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit të bërë publik ka vendosur që: dështimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë për të vendosur mbi kërkesën e Diana Kastratit për një urdhër për mbrojtje ka shkelur të drejtat njerëzore të saj.

Gjithashtu, në kuadër të kampanjës është dorëzuar edhe kërkesa në Gjykatën Kushtetuese në emër të Z. Rifat Osmani, një qytetar kosovar i cili mbahet në

paraburgim për afro katër vite në pritje të gjykimit dhe në mungesë të fakteve. Përkundër dëshmime të dobëta, Z. Osmani u akuzua në maj të vitit 2009 për veprën penale Ndihmë në Vrasje. Që nga ajo kohë Z. Osmani është mbajtur në paraburgim, ndërsa Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka dëshmuar paaftësinë për të mundësuar një gjykim të paanshëm e të shpejtë mbi rastin, ku do të përcaktohej sipas ligjit pafajësia apo fajësia e tij.

Kampanja “Drejtësia dhe Qytetarët” ka vazhduar me organizimin e tryezave me ekspertë. Në tryezën e parë, të mbajtur më 7 mars, u diskutua për: Të drejtat e Qytetarëve dhe Llogaridhënien në Sistemin e Drejtësisë. Ambasadorja Tracey Ann Jacobson dhe Zëvendëskryeministri Kuçi ju drejtuan mediave dhe ekspertëve të mbledhur gjatë fjalës së tyre hyrëse. Kjo tryezë u nda në tri panele, në të cilat u diskutua për temat: Të Drejtat e Viktimave të Krimin dhe Palët e Akuzuara në Kosovë, Transparenca në Sistemin e Drejtësisë në Kosovë dhe Llogaridhënia në Sistemin e Drejtësisë. Panelet u përcollën me diskutim të hapur, që kishin për qëllim identifikimin e çështjeve që zgjojnë vëmendje nga institucionet qeveritare dhe shoqëria civile.



Drejtësia dhe qytetarët
Pravda i ljudi
Justice and the people

KËRKO DREJTËSI TRAŽI PRAVDU



Ambasadorja e SHBA-ve Znj. Jacobson përmendi mungesën e përgjegjësive të treguar nga Gjykata Komunale e Prishtinës për rastin e shtetasës Diana Kasrati, duke thënë se Institucioni duhej t'i dilte në mbrojtje të ndjerës brenda 24 orëve duke shtuar se Gjykata në fjalë kishte dështuar të ofroj mbrojtjen ashtu siç parashihet me ligj.

Ministri i Drejtësisë, Z. Hajredin Kuçi, pranoi mangësitë që ka Gjyqësori Kosovar duke shtuar se “Gjyqësori duhet të rris më shumë transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve”.

Tryeza e radhës me ekspertë organizuar më 30 tetor nga kampanja Drejtësia dhe qytetarët dhe koordinuar nga ATRC, u titullua: Zbatimi i drejtësisë. Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Tracey Ann Jacobson, dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi në këtë tryezë iu drejtuan të pranishmëve me një fjalë rasti.

Ambasadorja Jacobson u bëri thirrje qytetarëve që të raportojnë keqpërdorimet gjatë zgjedhjeve, sepse sipas saj ata kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar zgjedhje fer dhe të lira. “Pasi jemi vetëm disa ditë para zgjedhjeve komunale, ju rikujtoj se zgjedhjet e lira janë po ashtu pjesë e drejtësisë. “Votuesit duhet t'i raportojnë keqpërdorimet, nëse do të ketë. Është në duart e qytetarëve se nëse shohin diçka, ata duhet të thonë

diçka”, tha Ambasadorja e SHBA've në Kosovë. Ndërsa, Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, në fjalimin e tij u fokusua më shumë në sistemin e drejtësisë, duke vënë theks të veçantë në atë se ligjet duhet t'i mbrojnë të gjithë, në veçanti ata që janë më të dobët: “Sigurisht që qytetarët, edhe ata më të dobët, kanë të drejtë të mbrohen dhe këtë duhet ta bëjë sistemi i drejtësisë, duhet ta bëjnë ligjet duhet ta bëjë kodi penal por duhet ta bëjë edhe gjyqësori, ai i cili në fund e ndan drejtësinë për qytetarët”.

Këto tryeza kanë për qëllim të mbledhin ekspertë, përfaqësues nga shoqëria civile dhe institucionet qeveritare për të diskutuar problemet specifike dhe metodat për të zgjidhur këto probleme për të përmirësuar Sistemin e Drejtësisë në Kosovë.

Në kuadër të Kampanjës “Drejtësia dhe qytetarët” gjatë këtij viti janë organizuar edhe punëtori për Avokim në katër komuna të Kosovës. Punëtoritë kishin për qëllim që të ngritjen kapaciteteve avokuese të nxënësve dhe të rinjëve në çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në përgjithësi, hartimin e rekomandimeve për politikën, negociimin me zyrtarët qeveritar, si dhe avokimi për ndryshime në sistemin e drejtësisë.

QYTETARË AKTIV - KOMUNA TË PËRGJEGJSHME DHE TRANSPARENTE

ATRC ka vazhduar implementimin e projektit “Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente”, i cili synon të rris pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Gjatë këtij viti ATRC ka organizuar trajnime dhe punëtori rreth procesit të identifikimit të nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Pjesëmarrës në punëtoritë e organizuara ishin zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të Komunës së Gjilanit, Vitisë, Novobërdës dhe Kamenicës. Qëllimi i organizimit të punëtorive ishte që të diskutohen mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, në veçanti rreth priorizimit të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve.

Gjatë periudhës maj-korrik ATRC organizoi takime me qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe Këshilla të fshatrave të katër komunave të regjionit të Gjilanit, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe rekomandimeve të qytetarëve. Kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve u përqëndruan kryesisht në rregullimin e infrastrukturës rrugore, vendosjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, etj. Nevojat dhe rekomandimet e qytetarëve të identifikuar nga ATRC janë përmbledhur në publikimin “Prioritetet e banorëve të katër Komunave të regjionit të Gjilanit”, i cili u prezantua në tryezën e përbashkët të organizuar me zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të katër komunave të regjionit të Gjilanit.

Procesi i identifikimit të prioriteteve nga qytetarët është vlerësuar nga vetë qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe këshillat e fshatrave. Kurse, zyrtarët e komunave shprehën gatishmërinë e tyre për vazhdimin e kësaj praktike: “Falenderoj ATRC që ka identifikuar prioritetet e komunës sonë. Ky dokument ka një rëndësi të madhe, sepse qytetarët janë ata që duhet të vendosin për kërkesat dhe prioritetet e tyre”, tha drejtori i administratës së përgjithshme të komunës

së Kamenicës z. Enver Ajvazi. Kurse, drejtori i Drejtorisë së financave, ekonomisë dhe zhvillimit të komunës së Gjilanit z. Nuhi Nuhiu theksoi: “Dokumenti, në të cilin janë përfshirë kërkesat dhe rekomandimet e drejtpërdrejta të qytetarëve, është një bazë e mirë dhe duhet të vazhdohet me këtë praktikë”.

Në kuadër të këtij projekti ATRC ka hartuar edhe strategjitë për adresimin e nevojave të komunitetit, si rezultat i punëtorive të organizuara me zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të katër komunave të regjionit të Gjilanit. Strategjitë për adresimin e nevojave të komunitetit janë prezantuar gjatë konferencës përfundimtare të organizuar në Gjilan.

ATRC edhe gjatë vitit të ardhshëm do të vazhdoj bashkëpunimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me qytetarë dhe zyrtarët komunal, në mënyrë që qytetarët të përfshihen drejtpërdrejt në procesin e krijimit të buxhetit komunal me pjesëmarrje, që nga faza e planifikimit deri në implementimin e tij.

Përmes aktiviteteve të realizuara në këtë projekt ATRC synon që të rris bashkëpunimin në mes Komunave dhe qytetarëve; t’i ofroj mundësinë qytetarëve që të shprehin lirshëm kërkesat dhe rekomandimet e tyre dhe të ushtrojnë presionin demokratik në institucionet lokale për marrjen në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë hartimit të planeve komunale dhe njëkohësisht t’i ndihmoj Komunave në procesin e hartimit të buxhetit komunal, duke i ofruar të dhëna konkrete për secilin fshat veç e veç.

Ky projekt mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme.

FUQIZIMI I QYTETARËVE DHE KOMUNAVE DREJT ZHVILLIMIT DEMOKRATIK

Nga marsi i këtij viti ATRC ka filluar implementimin e projektit Fuqizimi i qytetarëve dhe komunave drejt zhvillimit demokratik, i përkrahur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Projekti kishte për qëllim fuqizimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje, kontribimin në përmirësimin e marrëdhënieve në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve komunale dhe lehtësimin e mekanizmave të qeverisë lokale për angazhim të qytetarëve, që do të rezultojnë me rritjen e efektivitetit të shërbimeve publike.

Me qëllim të bashkëpunimit dhe mbështetjes në arritjen e qëllimit të projektit, ATRC fillimisht nënshkroi Marrëveshje bashkëpunimi me komunën Hanit i Elezit dhe Shtërpce. Projekti vazhdoi me ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të Shoqërisë civile dhe zyrtarëve komunal, përmes organizimit të trajnimeve dhe punëtorive në temat: “Qeverisja me pjesëmarrje”, “Përfshirja qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal” dhe “Buxheti me Pjesëmarrje”.

